

**KONGRESI I MANASTIRIT (1908) SIPAS HISTORIOGRAFISË
SHQIPTARE**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER HISTORI E KOHËS SË RE**

NGA

BEQIR KIQINA



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË**

MAJ, 2022

EKSPOZE E TEMËS
KONGRESI I MANASTIRIT (1908) SIPAS HISTORIOGRAFISË
SHQIPTARE

Mentor:

Prof. Assoc. Dr. Selim Bezeraj

Kandidati:

Beqir Kiqina

Kombi ynë shqiptar që nga periudhat e hershme e deri tek rilindja kombëtare shqiptare është ballafaquar me shumë sfida dhe luftëra të ndryshme si për aneksim teritorësh po ashtu është përballur edhe me ekzote të popullsisë shqiptare. Vetë sfidat në të cilat kaloj populli shqiptar që nga Perandoria Romake e deri tek Perandoria Osmane lanë pasoja të mëdha si në aspektin socio – ekonomik po ashtu edhe atë arsimor etj. Arsimi ishte një ndër elementet kryesore që ishte pengesë e vazhdueshme për vendin sepse gjendja e dobët arsimore bëri që pushtuesit të mbajnë më gjatë nënë robëri shqiptarët, e kështu sepse nuk qenë në gjendje të krijojnë aleanca të qëndrueshme me shtetet apo perandoritë e kohës pavarësisht luftërave të lavdishme.

Popullit shqiptar krahë luftës për pavarësi ndaj Perandorisë Osmane në dekadën e parë të shek. XX bëri edhe përpjekje për unifikim të arsimit e pikë kryesore ishte unifikimi i një alfabeti mbarëkombëtar, në vitin 1908 rilindësit nga mbarë vendi bënë përpjekje serioze që të gjejnë një kompromis dhe të harmonizojnë idetë e tyre në bazë të kërkesave të popullit dhe njëherë e përgjithmonë shqiptarët të kenë alfabetin e tyre.

Në historiografinë shqiptare është trajtuar dhe vazhdon të trajtohet nga historianët edhe sot e kësaj dite Kongresi i Manastirit që u mbajti me 14 deri 22 nëntor 1908 në Manastir ku ishin mbledhur elitat intelektuale, politike, patriotike edhe fetare duke përfshi klerikët e të gjitha besimeve në Shqipëri vetëm që vendit të jepnin atë që meritonte pra një alfabet shqiptar.

Historianet si Hysni Myzri, Shaban Demiraj, Krisaq Prifti, Ramiz Avdyli Tmor Osmani etj në librat e tyre pohojnë se deri para vitit 1908 në Shqipëri përdorëshin alfabetet të ndryshme si: turk, arab, grek e në fillim të shek. XX ishin ven në përdorim edhe alfabetet e shoqërisë “Bashkimi” dhe “Agimi” por gjendja arsimore ishte shumë e vështirë në institucionet arsimore dhe ndikimet e jashtme nga shtet përreth.

Ky punim i temës së diplomës në nivelin master është punuar duke pasur parasysh të dhënat historike dhe duke u bazuar në trajtimin objektiv të tyre në aspektin historiografik, kemi parasysh se Kongresi i Manastirit 1908 është një ngjarje mjaftë e rëndësishme për nga pesha historike sepse bart në vete vlerë të madhe në aspektin arsimor por edhe shkencor në këtë kongres përveç alfabetit u hap rrugë e pashmangshme drejt pavarësisë së shtetit shqiptar që u shpall pas katër viteve me 1912.

Në këtë punim kam përdorur metodat historike të trajtimit sa më serioz të Kongresit të Manastirit sipas historiografisë shqiptare metodat në këtë punim janë: metoda e induksionit dhe deduksionit duke i trajtuar të dhënat historike nga e përveçmja tek e përgjithshmja dhe e kundërta, për të bërë sa më të qëndrueshëm argumentin kam përdor edhe metodën analogjike. Duke pasur parasysh se trajtimi i Kongresit të Manastirit sipas historiografisë duhet të ketë argumente sa më objektive që na dërgojnë nga e vërteta më e plotë atëherë kam përdorur dhe metodën krahasuese duke i krahasuar dhe analizuar autorët shqiptar të cilët kanë shkruar në librat e tyre, dihet mirë se për Kongresin e Manastirit ka shkrime relativisht shumë por që sipas asaj që unë kam hasur në këtë studim nuk ka shkrime të autorëve shqiptar të cilat janë harmonizuara.

Ky punim i diplomës përmban tre kapituj në kapitullin e parë e parë trajtohet gjendja arsimore dhe shkollat si institucione në fillim të shek XX-të, në kapitullin e dytë trajtohet rëndësia e Kongresit të Manastirit në kontekstin historik dhe kapitulli i tretë trajton rendësin e klerit fetar dhe kontributin e tyre në raport me zgjidhjen e një alfabeti shqip. Kongresi i Manastirit është trajtuar dhe vazhdon të trajtohet ende nga autor të ndryshëm në forma të ndryshme dhe sipas meje ende nuk e ka një trajtim meritor ashtu sikur meriton ta ketë, sepse nga ky kongres është vendosur edhe e ardhmja e gjuhës shqipe dhe gjuha jonë që 113 vite shënohet me alfabetin latin që u vendos mu aty nga rilindësit tanë dhe tani njihet edhe ndërkombëtarisht.

Gjatë punimit të temës jam munduar të paraqes sa më mirë që kam mundur sfidat në të cilat u ballafaquan rilindësit që të gjejnë një formulë sesi të dilej nga gjendja e rënd ku ndodhej vendi dhe arsimit në përgjithësi, e kështu në punim i kam paraqitur edhe mendimet pro dhe kundër personaliteteve që morën pjesë në kuvend si të Mithat Frasherit, Gjergj Fishtës etj. Ndërsa kam bërë përpjekje që edhe rolin e klerit fetar mysliman dhe krishter të paraqes duke u bazuar në të dhënat e autorëve një nga autorët të cilët kanë hulumtuar dhe ka paraqitur rolin e klerit fetar është Nuredin Ahmeti në librin e tij: *Krerët Fetar në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1878-1912*.

Në fund të punimit, si zakonisht janë dhënë edhe konkluzionet e ndryshme ndër të cilat i veçojmë:

- Kongresi i zhvilloi punimet në lokalet e klubit “Bashkimi” të Manastirit, prej 14 – 22 nëntor 1908. Në kongres morën pjesë 51 delegatë. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri, nënkryetarë Luigj Gurakuqi dhe Gjergj Qiriazhi. Në ditën e tretë të punimeve të Kongresit delegatët zgjodhën një komision të veçantë për çështjen e abesë. Kryetar i Komisionit u zgjodh Gjergj Fishta. Pas shumë diskutimesh nuk u arrit të caktohej një alfabet i vetëm, por u miratuan dy alfabete: ai Stambollit dhe një alfabet i përbërë vetëm nga shkronja latine që ishte shumë i afërt me atë të shoqërisë Bashkimi të Shkodrës.
- Kleri fetar ka luajtur një rol të rëndësishëm në punimet e Kongresit të Manastirit sidomos ai katolik i përber nga Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi dhe Ndre Mjeda. Roli i Gjergj Fishtës në Kongresin e Manastirit dhe në komisionin e hartimit të alfabetit ka qenë i veçantë . Duke sjellë në komision alfabetin e shoqërisë “Bashkimi” përfaqësues i së cilës ishte, Gj. Fishta arriti ta verë në një rrafsh për t’u diskutuar me alfabetin e Stambollit, megjithëse përkrahësit e tij po pakësoheshin dita-ditës, por kishte meritën historike se që alfabeti i parë i miratuar nga një komision, kishte një letërsi të shkruar me të dhe me alfabetin e shoqërisë “Agimi”, që kishte pasur përkrahjen e filologëve më të shquar të kohës.
- Po ashtu edhe kryetari i Kongresit të Manastirit që ishte mysliman i sektit bektashinj Mithat Frashër dha një kontribut mjaft të madh në çështjen e përcaktimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Gjithashtu një rol në këtë kongres e ka luajtur edhe kleri mysliman i vilajetit të Kosovës e sidomos Haxhi Vildan efendiu. Duhet të përmendet që edhe roli i klerit protestant ka qenë mjaft i madh në Kongres duke dhënë një ndihmesë të madhe në lëvrimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe.
- Në historinë e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar, Kongresi i Manastirit shënon një ngjarje të rëndësishme politike, kulturore, shkencore (gjuhësore) dhe arsimore. Kongresi i Manastirit është kongresi i alfabetit kombëtar të shqipes, që u përpilua dhe u miratua prej të gjithë delegatëve pjesëmarrës, pra alfabeti që përdorim sot ne shqiptarët.
- Alfabeti kombëtar i sotëm është kurorëzimi i një pune disa shekullore, një proces që zgjati afër katër shekuj dhe që u përfundua në nëntor të vitit 1908 me punën e Komisionit të Kongresit të Manastirit.

- Deri në këtë datë, në Shqipëri janë përdorur disa alfabetë nga intelektualë, shoqëri e klube politike, kulturore, arsimore dhe institucione të ndryshme. Në rrethanat e pushtimit shekullor turk përdorëshin alfabetë të ndryshme në shkrimin e shqipes, të cilët ishin krijuar nga lëvruet të gjuhës shqipe, shkrimtarë, gazetarë etj., kështu që shqiptarët u detyruan ta shkruajnë gjuhën e tyre, sipas mundësive e konceptimeve individuale, me alfabetë të ndryshme: me shkronja latine, greke, turke-arabe, e më rrallë edhe me shkronja të veçanta.

- Për shkak të përdorimit të disa alfabeteve, në shkrimin e shqipes vërehej një anarki e vërtetë: dëmtohej kultura tradicionale, arsimi i njësisshëm dhe uniteti kombëtar. Ky problem ishte i vështirë dhe kërkonte zgjidhje.

- Kur lëvizja jonë për çlirim kombëtar ishte në rritje, kërkesa për një alfabet të përbashkët për të gjithë shqiptarët u shtrua për zgjidhje urgjente nga rilindësit tanë, sidomos gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, si objektivi numër një i Rilindjes Kombëtare për gjuhën, kulturën dhe për pavarësinë kombëtare shqiptare. 28 Zgjidhja e problemit ishte zvarritur kryesisht për shkaqe objektive.

- Shkaku i parë që i ka penguar shqiptarët në zgjidhjen e shpejtë të problemit të alfabetit, lidhet me rrethanat politike që ka përjetuar Shqipëria nën pushtimin shekullor turk, gjatë të cilit shqiptarëve u janë mohuar në mënyrë të veçantë të drejtat e elementare. Kjo ka ndodhur për shkak të luftës heroike të popullit tonë nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut kundër Perandorisë turke.

- Për këtë arsye shqiptarët, siç dihet, nën rrethanat e pushtimit të huaj nuk lejoheshin të shkruanin e të lëvronin gjuhën e tyre amtare, shkollat shqipe nuk lejoheshin të hapeshin në një kohë që Shqipëria po mbytej nga shkollat e huaja turke, greke, sllave, etj. Të njëjtën politikë shkombëtarizuese ndiqnin ndaj Shqipërisë edhe fqinjët tanë.

- Turqia impononte alfabetin arabo-turk, Greqia alfabetin grek etj, pra shkaku i parë lidhet me faktorin e jashtëm. Shkaku i dytë është pasojë e të parit dhe ka të bëjë me faktin se problemet madhore, siç është edhe rasti i përpilimit e miratimit të një alfabeti kombëtar, zgjidhen me marrëveshje dhe punë të organizuar institucionale kombëtare, çka në rrethanat e sipërpërmendura nuk ishte e lehtë të realizoheshin.

- Shkaku tjetër, që vështirësonte zgjidhjen e problemit të alfabetit të përbashkët për të gjithë shqiptarët ishte thjesht i karakterit shkencor; ai kishte të bënte me sistemin e pasur dhe

në disa raste origjinal të tinguj-fonemave të shqipes, për shkrimin e të cilëve kërkoheshin më shumë shkronja sesa kishte latinishtja ose gjuhët e tjera.

- Prandaj çështja e alfabetit u zgjidh në prag të Pavarësisë së Shqipërisë, në Kongresin e Manastirit, kur iu hap rruga edhe zgjidhjes së shumë çështjeve të tjera të rëndësishme për popullin shqiptar, siç kanë qenë shpallja e pavarësisë së vendit (1912), si dhe njësimi i gjuhës letrare shqipe në Kongresin e Gjuhës Shqipe.